



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.280 Prot.

Tiranë, më 16.02.2023

V E N D I M

Nr. 30 , datë 16 . 02. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 109 Regj, datë 14.07.2022, paraqitur nga H.O (në vijim ankuesja), kundër Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore Pogradec, me pretendimin për diskriminim për shkak të “moshës” dhe “gjendjes shëndetësore”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja H.O shpjegon se, është banore e qytetit të Pogradecit. H.O është ankuar pranë sigurimeve shoqërore Pogradec, sepse pas marrjes së pensionit nuk ishte trajtuar me fondin e rezistencës sociale për muajt prill-qershor 2022. Në lidhje me këtë problematikë ankuesja i është drejtuar edhe Drejtorisë Rajonale Korçë, por sipas saj, ka marrë një përgjigje të pabazuar në ligj.

Ankuesja pretendon se pagesa e fondit të rezistencës sociale i takon pasi përmbush dy kriteret e vendosura:

- Është pensioniste e vetmuar, banon në shtëpinë e vajzës;
- Ka një pension jo më shumë se 50% e pagës minimale sipas VKM.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, ankuesja kërkon nga Komisioneri që të informohet ligjërisht nga ana e institucioneve përgjegjëse se përse nuk e ka përfituar pagesën, pasi ndihet e diskriminuar si e moshuar 86 vjeçare, pasi nuk ka mundësi që të shkojë nëpër zyra, si dhe të përfitojë pagesën për tre muaj nga fondi i rezistencës sociale.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, rezultoi se informacioni i depozituar së bashku me ankesën, nuk ishte e mjaftueshëm për të vijuar me procedurat e mëtejshme hetimore. Ankesa u plotësua me informacionin e nevojshëm për të vijuar më tej procedurat e shqyrtimit në datën 22.08.2023, nëpërmjet Zyrës Rajonale Korçë, të Komisionerit.

Pasi ankesa e pararitur ishte në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD, e ndryshuar, ajo u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1037/2 prot., datë 25.08.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore Pogradec, në lidhje me pretendimet e parashtruara nga pala ankuese. Kjo kërkesë iu përcoll për dijeni edhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë (në vijim DRSSH Korçë).

1.1 Me shkresën nr.710 prot., datë 26.08.2022, Agjencia e Sigurimeve Shoqërore Pogradec ktheu përgjigje, duke informuar se, në lidhje me H.O duhet t'i drejtoheni DRSSH Korçë, pasi nga ana e tyre nuk dispononin dokumentacionin e kërkuar në lidhje me ankuesen.

1.2 Me shkresën nr. 8841 prot, datë 31.08.2022, DRSSH Korçë, informoi Komisionerin si më poshtë:

Bazuar në VKM nr.159, datë 12.03.2022 *“Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë”*, përfitojnë mbështetje financiare, në masën 3 000 (tre mijë) lekë/muaj për një periudhë tre mujore, kategoritë e mëposhtme:

- Familjet dhe individët përfitues të ndihmës ekonomike, të përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr.57/2019, *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”*;
- Individët përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr.57/2019, *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”*;
- Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, *“Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”*, të ndryshuar;
- Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, *“Për statusin e të verbrit”*, të ndryshuar;
- Personat, që përfitojnë pension invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar;
- Personat, që përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar;
- Personat, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe masa e pensionit mujor të tyre është më e ulët ose e barabartë me 50% të pagës minimale neto në shkallë vendi;
- Kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe përfitojnë kompensim për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, nr.238, datë 7.4.2010, “Për një ndryshim në vendimin nr.565, të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike””, nr.8, datë 14.1.2015, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.

H.O nuk plotëson kushtet e VKM nr.159, datë 12.03.2022 *“Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë.”* Masa e pensionit në datën 31.03.2022, është më e lartë se 50 % e pagës minimale neto në shkallë vendi. 50% e pagës minimale neto në shkallë vendi në datën 31.03.2022 është 13320 lekë/muaj, ndërkohë masa e pensionit të H.O është 14449 lekë/muaj.

2. Me shkresën nr.1037/4 prot., datë 20.09.2022, Komisioneri kërkoi nga DRSSH Korçë, informacion në lidhje me situatën e H.O për sa i përket përfitimit nga ana e saj të kompesimit për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”*, nr.238, datë 7.4.2010, *“Për një ndryshim në vendimin nr.565, të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”*”, nr.8, datë 14.1.2015, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj.”*

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr.9504/1 prot datë 22.09.2022, DRSSH Korçë informoi Komisionerin se:

Sipas dokumentacionit që administrohet në dosje, H.O nuk përfiton kompesim për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”*, nr.238, datë 7.4.2010, *“Për një ndryshim në vendimin nr.565, të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”*”, nr.8, datë 14.1.2015, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj.”*

Nëse plotëson ose jo kushtet për të përfituar kompesim sipas akteve të mësipërme, znj. H.O duhet të aplikojë dhe të dorëzojë dokumentacion që kërkohet sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave. Pas aplikimit kërkesa do të shqyrtohet dhe DPSSH Korçë do të shprehet me vendim.

3. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 1037/6 prot., datë 11.10.2022, Komisioneri njoftoi ankuesen, DRSSH Korçë dhe Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore Pogradec, për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 25.10.2022 ora 10:00. Së bashku me njoftimin e seancës dëgjimore, ankueses i'u komunikuan përgjigjet e dërguara nga DRSSH Korçë me anë të shkresave nr.9504/1 prot, datë 22.09.2022 dhe nr.8841 prot, datë 31.08.2022.

Seanca dëgjimore nuk u zhvillua, pasi asnjë nga palët nuk u paraqit në seancë apo kërkoi shtyrjen e saj për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja H.O, e datëlindjes 06.08.1936 është banore në qytetin e Pogradecit. Në bazë të certifikatës familjare me nr. 000942201, lëshuar në datën 09.08.2022 nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile Pogradec 263, Njësia Administrative Pogradec, Bashkia Pogradec, H.O, është me gjendjes civile e ve dhe e vetme në përbërjen familjare. Në bazë të informacionit të administruar rezulton se ankuesja përfiton pension pleqërie në masën 14 449 lekë në muaj.

Në kuadër të politikave të mbrojtjes sociale, bazuar në Vendimin e këshillit të Ministrave nr.159, datë 12.03.2022 *Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë*”(në vijim VKM nr.159, datë 12.03.2022), disa kategori personash në nevojë, kanë përfituar një mbështetje financiare, në masën 3 000 (tre mijë) lekë/muaj për një periudhë tre mujore.

Ankuesja H.O nuk ka përfituar mbështetje financiare sipas VKM nr.159, datë 12.03.2022 dhe pretendon se duhet të kishte përfituar mbështetje financiare sipas kësaj VKM-je, pasi plotëson dy kriteret e vendosura në këtë VKM, është pensioniste e vetmuar dhe ka një pension jo më shumë se 50% e pagës minimale. Duke mos qenë dakort me një fakt të tillë, ankuesja ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi pranë Komisionerit duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore, pasi nuk ka përfituar mbështetjen financiare të dhënë nga VKM nr.159, datë 12.03.2022.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në Kreun IV, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD, në nenin 20, pika 1, përcakton se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”. Më specifikisht në pikën 2, germa “c”, të nenit 20, të LMD, parashikohet se : “2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;”

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen në përfitimet të mbështetjes sociale dhëna në bazë të VKM nr.159, datë 12.03.2022;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose më shumë, nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në kuadër të vlerësimit të bërë nga strukturat e sigurimeve shoqërore, të cilat kanë vlerësuar se ankuesja nuk plotëson kushtet e VKM nr.159, datë 12.03.2022. Nëse konstatohet se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pafavorshme dhe të pabarabartë, atëherë do të vijohet me analizën, nëse ky trajtim të cilit i është nënshtruar ankuesja ka ardhur apo jo si rezultat i shkaqeve të pretenduara prej saj, të cilat duhet gjithashtu të gëzojnë mbrojtje nga ligji. Në rast se nuk konstatohet ndonjë trajtim i padrejtë dhe i pafavorshëm dhe i pabarabartë, Komisioneri nuk do të vijojë me pjesën tjetër të analizës.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri konstaton se, në bazë të VKM nr.159, datë 12.03.2022 është vendosur përfitimi i një mbështetje financiare në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj për një periudhë tremujore, për kategoritë e mëposhtme:

- a) Familjet dhe individët përfitues të ndihmës ekonomike, të përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr.57/2019, *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”*;
- b) Individët përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr.57/2019, *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”*;
- c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, *“Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”*, të ndryshuar;
- d) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, *“Për statusin e të verbrit”*, të ndryshuar;
- e) Personat, që përfitojnë pension invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar;
- f) Personat, që përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar;
- g) Personat, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe masa e pensionit mujor të tyre është më e ulët ose e barabartë me 50% të pagës minimale neto në shkallë vendi;

h) Kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe përfitojnë kompensim për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, nr.238, datë 7.4.2010, “Për një ndryshim në vendimin nr.565, të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike””, nr.8, datë 14.1.2015, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.

Sipas pikës 5, të VKM nr.159, datë 12.03.2022, parashikohet se : “5. Mbështetjen financiare e përfitojnë personat e kategorive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të cilët kanë të drejtë për përfitim deri në datën 31 mars 2022 dhe kanë të drejtë të marrin vetëm një herë këtë mbështetje financiare pavarësisht se mund të jenë të përfshirë në më shumë se një kategori.”

Në bazë të VKM nr.159, datë 12.03.2022, rezulton se, kategoritë në nevojë të cilët janë përfituese të mbështetjes financiare, janë personat me aftësi të kufizuar, pensionistët dhe personat që janë përfitues të pensionit familjar. Në bazë të parashtrimeve të saj, ankuesja pretendon se duhet të ishte përfituese e ndihmës financiare sipas VKM nr.159, datë 12.03.2022, brenda kategorisë së pensionistëve. Në këto kushte edhe shqyrtimi i pretendimeve të ankueses do të bëhet në kuadër të kategorive të parashikuara nga gerat “g” dhe “f” të VKM nr.159, datë 12.03.2022 . Kategoritë e tjera të parashikuara nga VKM nr.159, datë 12.03.2022 nuk do të merren në shqyrtim, pasi ankuesja nuk ka pretenduar se është person me aftësi të kufizuar apo është përfituese e pensionit familjar.

Në bazë të gërmas “g”, të pikës 1, të VKM nr.159, datë 12.03.2022, personat që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë përfituese sipas kësaj VKM-je, vetëm në rast se masa e pensionit mujor të tyre është më e ulët ose e barabartë me 50% të pagës minimale neto në shkallë vendi.

Në bazë të VKM nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga bazë minimale bruto në shkallë vendi deri në datën 31.03.2022 ka qenë 32 000 (tridhjetë e dy mijë) lekë. Referuar kësaj VKM-je, paga bazë minimale neto përlloraget në masën 26640 (njëzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzetë) lekë në muaj, ndërsa 50 % i pagës minimale neto në shkallë vendi deri në datën e lindjes së përfitimit përlloraget në vlerën 13 320 (trembëdhjetë mijë e treqind e njëzetë) lekë në muaj.

Deri në datën 31.03.2022, ankuesja ka qenë përfituese e një pensioni pleqërie sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe masa e pensionit mujor të saj ka qenë 14 449 (katërmëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e nëntë) lekë në muaj.

Sa më sipër rezulton se ankuesja H.O nuk është kategori përfituese e ndihmës financiare, sipas germës “g”, të pikës 1, të VKM nr.159, datë 12.03.2022, pasi masa e e pensionit mujor që ajo përfiton është më e lartë se 50 % e pagës minimale neto në shkallë vendi.

Në bazë të germës “h”, të pikës 1, të VKM nr.159, datë 12.03.2022, personat që që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, janë përfituese sipas kësaj VKM-je, pa u kushtëzuar nga masa e pensionit mujor, nëse janë kryefamiljarë dhe përfitojnë kompensim për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, të ndryshuar dhe nr.8, datë 14.1.2015.

Në bazë të certifikatës familjare të administruar, rezulton se ankuesja është pensioniste kryefamiljare, por ajo nuk rezulton të jetë përfituese e kompensimit për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, të ndryshuar dhe nr.8, datë 14.1.2015. Skema e kompesimit të energjisë elektrike, sipas VKM-ve të sipërcituara, është një skemë e cila bazohet në aplikimin e personave. Gjatë shqyrtimit, nuk rezultoi që ankuesja të ketë aplikuar për të përfituar kompesim të energjisë elektrike, sipas VKM të mësipërme.

Komisioneri vlerëson se, për të përfituar sipas germës “h”, të pikës 1, të VKM nr.159, datë 12.03.2022, vlerësimi nëse një pensionist, i cili është kryefamiljar, është përfitues i skemës së kompesimit të energjisë elektrike sipas VKM nr.565, datë 9.8.2006, të ndryshuar dhe nr.8, datë 14.1.2015, është një vlerësim, i cili bëhet veçmas, sipas parashikimeve të VKM-të respektive, dhe se nuk mund të kryhet në kuadër të procedurave që janë ndjekur nga institucionet e ngarkuara në kuadër të zbatimit të VKM nr.159, datë 12.03.2022. Në këtë kontekst, në momentin që i ka lindur e drejta për të përfituar mbështetjen financiare, ankuesja përveç se duhet të ishte kryefamiljare që përfitonte pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, kushte këto që plotësohen, në mënyrë kumulative, ajo duhet të ishte përfituese në kuadër të skemës së kompesimit të energjisë sipas VKM nr.565, datë 9.8.2006, të ndryshuar dhe nr.8, datë 14.1.2015, kusht të cilin ankuesja nuk rezulton e provuar që ta përmbushë.

Sa më sipër rezulton se ankuesja H.O nuk është kategori përfituese e ndihmës financiare, sipas germës “h”, të pikës 1, të VKM nr.159, datë 12.03.2022, pasi ajo nuk është përfituese e skemës së kompesimit të energjisë elektrike sipas VKM nr.565, datë 09.08.2006 , të ndryshuar dhe nr.8, datë 14.01.2015.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesja H.O, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses H.O, për shkak të “*moshës*” dhe “*gjendjes shëndetësore*”
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Mosha, Gjendja shëndetësore
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim